VENDIM
Nr.212, datë 11.3.2020

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE

(Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 29.7.2020, nr. 1131, datë 24.12.2020; nr. 204, datë 25.3.2021; nr. 572, datë 6.10.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, pika 3, shkronja "b", nënndarja "i", 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore (projektimin, zbatimin e punimeve, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e këtyre objekteve) në vlerën, gjithsej, në masën 9 531 941 818 (nëntë miliardë e pesëqind e tridhjetë e një milionë e nëntëqind e dyzet e një mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, përkatësisht:

i. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në vlerën, gjithsej, 4 347 753 223 (katër miliardë e treqind e dyzet e shtatë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet e tre) lekë;

ii. Bashkisë Tiranë, në vlerën, gjithsej 5 184 188 593 (pesë miliardë e njëqind e tetëdhjetë e katër milionë e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.

2. Përdorimi i fondit, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, të jetë në masën 5 001 173 797 (pesë miliardë e një milion e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 3 996 619 878 (tre miliardë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekësh pa TVSH;

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 1 004 553 919 (një miliard e katër milionë e pesëqind e pesëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë) lekësh pa TVSH.

2.1 Përdorimi i fondit, për vitin 2021, do të jetë në masën 3 928 793 173 (tre miliardë e nëntëqind e njëzet e tetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë, nga i cili Bashkisë Tiranë, për vitin 2021, i transferohet fondi prej 3 928 793 173 (tre miliardë e nëntëqind e njëzet e tetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit dhe mobilimit të objekteve arsimore, në Bashkinë Tiranë.

4. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit, në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin "Fondi për rindërtim", të buxhetit të shtetit

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama